

ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË SË DREJTORISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR VITIN 2024



13 Shkurt 2025

Në zbatim të Urdhrit nr. 13, datë 16.01.2025, të Kryetarit të KLSH-së, “Për kryerjen e analizës vjetore të veprimtarisë së departamenteve të KLSH-së, për vitin 2024”, në datën 13 Shkurt 2025 Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në KLSH kreu analizën e veprimtarisë së saj për vitin 2024. Analiza u fokusua në drejtimet e mëposhtme:

Së pari, u pasqyrua përgjegjshmëria e realizimit të planit vjetor të auditimeve si dhe trajtoi menaxhimin e burimeve, treguesit dhe matësit e performancës, si dhe shkallën e pajtueshmërisë me standardet profesionale të auditimit të brendshëm.

Së dyti, me anë të tij u komunikuan rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm duke pasqyruar problemet më të rëndësishme të identifikuar dhe të trajtuara në secilin mision auditimi.

Misioni i Auditimit të Brendshëm

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm luan një rol të rëndësishëm dhe me impakt të veçantë pasi kontribuon dhe ndihmon KLSH-në për të arritur objektivat, duke përmirësuar efektshmërinë e menaxhimit të riskut, identifikimit të dobësive të sistemit menaxherial, evidentimin e problematikave të ndryshme dhe dhënien e rekomandimeve me qëllim përmirësimin e punës.

Është qëllimi i kësaj Drejtorie, ashtu si dhe vet qëllimi i çdo strukture auditimi përmirësimi gjithmonë e më tepër i punës duke promovuar eficiencën, përgjegjshmërinë, efektivitetin dhe transparencën.

Realizimi i vet misionit dhe vizionit të KLSH-s, në vetvete është kontribut i gjithë Departamenteve dhe Drejtorive të këtij institucioni.

Në sfidat aktuale që hasim çdo ditë e më tepër, një staf kompetent dhe i pavarur që e kryen veprimtarinë në përputhje me ligjet dhe standardet profesionale është një domosdoshmëri për çdo strukturë dhe institucion.

DAB në KLSH ka kryer veprimtarinë e saj në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” si dhe akteve të tjera të dala në zbatim dhe plotësim të kuadrit ligjor për veprimtarinë e AB, të cilat përbëjnë parimet dhe kërkesat themelore për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Kontrollin e Lartë të Shtetit ka funksionuar si Drejtori në varësi të Kryetarit të KLSH sipas strukturës së miratuar me Vendimin nr. 19, datë 31.01.2022 “Mbi miratimin e strukturës organizative të Kontrollit të Lartë të Shtetit, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave”, të ndryshuar dhe përbëhet nga 3 punonjës, 1 drejtor dhe 2 specialistë auditues. Anëtarët e DAB kanë arsim të lartë për shkencë ekonomike dhe juridike dhe kanë ndjekur procesin e trajnimit vjetor prej 40 orësh, të organizuar nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË SË DREJTORISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR VITIN 2024

Kryerja e angazhimeve të auditimit të brendshëm është bërë në zbatim të Planit Vjetor të Auditimit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm i miratuar nga Kryetari i KLSH me Vendimin nr. 192, datë 20.10.2023, ndryshuar me Vendimin nr.186, datë 01.10.2024, “Për miratimin e ndryshimit të Planit Vjetor të vitit 2024”, ku janë planifikuar 6 misione auditimi me bazë sistemi. Llogaritja për numrin e planifikimit të misioneve të auditimit është bërë duke patur parasysh strukturën me burimet njerëzore të DAB-së.

Për periudhën raportuese janë planifikuar 6 misione auditimi me bazë sistemi dhe janë realizuar 6 të tilla. Më konkretisht:

- 1.Misioni i auditimit “Mbi auditimin e Sistemeve dhe Përputhshmërisë në Fushën e Menaxhimit Financiar”. Në përfundim të këtij auditimi është konkluduar në dy gjetje për të cilat janë lënë edhe rekomandimet përkatëse në Raportin Final të auditimit .
- 2.Misioni i auditimit “Mbi auditimin e Sistemeve dhe Përputhshmërisë në Departamentin e Auditimit të Institucioneve Qendrore”. Në përfundim të këtij auditimi është konkluduar në dy gjetje për të cilat janë lënë edhe rekomandimet përkatëse në Raportin Final të auditimit.
- 3.Misioni i auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar në periudhën 08.03.2021 – 07.04.2021 në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja”. Në përfundim të këtij auditimi është verifikuar zbatimi i 3 rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
- 4.Misioni i auditimit “Mbi auditimin e Sistemeve dhe Përputhshmërisë në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit”. Në përfundim të këtij auditimi është konkluduar në 1 gjetje për të cilin është lënë edhe rekomandimi përkatëse në Raportin Final të auditimit.
- 5.Misioni i auditimit “Auditim Përputhshmërie në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore”. Në përfundim të këtij auditimi është konkluduar në 3 gjetje për të cilat janë lënë edhe rekomandimet përkatëse në Raportin Final të auditimit.



6.Misioni i auditimit “Auditim Përputhshmërie në Sektorin e Komunikimit dhe Botimeve”. Në përfundim të këtij auditimi është konkluduar në 2 gjetje për të cilat janë lënë edhe rekomandimet përkatëse në Raportin Final të auditimit.

Përveç misioneve të auditimit me bazë sistemi, DAB në zbatim të kapitulli IV, pika 4.1.13 të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Brendshëm në Sektorin Publik”, ka kërkuar informacion mbi progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe për të cilat është rënë dakord, sipas afateve të përcaktuara në plan veprimet e dakordësuara më parë me subjektet e audituara dhe nivelin e lartë menaxherial. Vlen të theksohet se bashkëpunimi dhe gadishmëria për implementimin e rekomandimeve të lëna ka qenë e kënaqshme.

Për të rritur cilësinë e auditimeve në vitin 2024 është kryer në vazhdimësi rishikimi i punës së audituesve. Referuar procedurave të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm, rishikimi dhe vlerësimi i cilësisë për materialet e auditimit (raportet paraprake, raportet finale, memo etj) është realizuar gjatë procesit të auditimit, nga përgjegjësi i grupit dhe Drejtori i Drejtorisë.